ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PEJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **635-22-11435-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në Rugovë LOT 1 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Varri i Sykut – Bellopaq" faza I LOT 2 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin "Shtype i Madh- Qafa e Broqit LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin " Rekë e Allagës- Pecaj" LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Koshutan – Gunishtë LOT 5 Asfaltimi i rrugës " Koshutan Pepajë " LOT 6 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Kuqisht (Lagjja e Bardhaj) LOT 7 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dugaivë vazhdim pjesa II**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Rexha**
NUI	**810515223**
Adresa	**Kroi i Bardhë Lam.A Nr. I Nr.107**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044159944**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Samir Rexha**
Adresa elektronike	**rexhashpk18@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**29.06.2023**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

LOT 1 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Varri i Sykut – Bellopaq" faza I

Ankese ne lidhje me vendimin per dhenie te Autoritetit Kontraktues per Lot 1 Ndertimi dhe asfaltimi i rruges " Varri i Sykut-Bellopaq"-faza 1

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Brenda afatit ligjor kemi parashtruar Kerkesen per Rishqyrtim me date 19.06.2023. Me date 20.06.2023 kemi pranuar vendimin per refuzim te kesaj kerkese.

Tek dokumentet shtese gjeni te bashkangjitur vendimin e AK.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi,

Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve,

Neni 60 Kriteret per Dhenien e Kontrates,

Neni 38 Sqarimi i Tendereve i Rregullores nr.001/2022 teProkurimit Publik,

Neni 45 Procedura per ekzaminimin, Vleresimin dhe Krahasimin e tendereve i Rregullores nr.001/2022 te Prokurimit Publik,

Pika 10 Sqarimi i tendereve gjate procesit te vleresimit te tendereve i Udhezuesit Nr.001/2023 Per Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1. Autoriteti Kontraktues –Komuna e Pejes me date 04.11.2022 ka publikur Njoftimin per Kontrate **Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në Rugovë**

LOT 1 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Varri i Sykut – Bellopaq" faza I

LOT 2 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin "Shtype i Madh- Qafa e Broqit

LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin " Rekë e Allagës- Pecaj"

LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Koshutan – Gunishtë

LOT 5 Asfaltimi i rrugës " Koshutan Pepajë "

LOT 6 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Kuqisht (Lagjja e Bardhaj)

LOT 7 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dugaivë vazhdim pjesa II.

Pas publikimit te ketij njoftimi ne si Operator Ekonomik kemi aplikuar per Lotin e 1 **Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës " Varri i Sykut – Bellopaq" faza I** dhe jemi shpallur fitues me date 26.01.2023 mbi bazen e cmimit me te ulet dhe kritereve tjera.

Operatoret tjere ekonomik brenda afatit ligjor kane parashtruar Kerkesa per rishqyrtim ku keto te fundit jane refuzuar nga ana e Autoritetit Kontraktues per te vazhduar me vendimin e dhene, per te vazhduar metutje me Ankesat ne OSHP te cilat i dhane kahje tjeter kesaj procedure prokurimi.

Pas aprovimit te ankeses (nga ana e OSHP-se) se operatorit ekonomik Graniti SHPK Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te padiskutueshme te nenit 38 te Rregullores se Prokurimit Publik ku ceket se Per ta lehetesuar ekzaminimin, vleresimin dhe krahasimin e tendereve AK mund te kerkoj nga secili tenderues individualisht per sqarim te tenderit te tij/saj.Lejohet qe nje autoritet kontraktues gjate vleresimit te kerkoje dhe te marre informacione apo dokumente te cilat mungojne ne aplikacion/tender.Ne kete rast AK pa bere asnje tentim per sqarim te dokumenteve mori vendim me date 12.06.2023 per eleminimin tone nga kjo procedure edhe pse dy here jemi shpallur fitues nga po ky komision vleresimi.

Pretendimi i pare i OE ankues Graniti SHPK nuk qendron fare dhe eshte totalisht i papranueshem. Lista e kontratave e prezentur gjate fazes se ofertimit nga ana jone jo vetem qe permbush kerkesen e AK per vleren prej 1.400.000.oo Euro por e tejkalon ate. Kur jemi te kerkesa kontrata te ngjajshme atehere ne te hyjne te gjitha kontratat e ndertimit te ulet pasiqe askund nuk ceket qe kontratat duhet te jene patjeter vetem per rruge.

Autoriteti Kontraktues nuk ka kerkuar fare sqarime per asnje nga referencat e prezentura. Ne jemi te vetedijshem qe mungon referenca per projektin Ndertimi i Rruges Barileve-Besi me vlere 965.582.96 Euro te cilen e posedojme dhe eshte e listuar ne Liste te Projekteve(projekti numer 4), andaj mund ta sqarojme kete pike. Eksperti shqyrtues konsideron se mund te merren parasysh vetem kontrata me nr.11 qe ka vlere 134.818.00 dhe kontrata me nr.16 me vlere 312.542.32. Keto dy kontrata se bashku me kontraten " Ndertimi i ruges Barileve-Besi" permbushin kerkesen e AK per 1.4 milion referenca tre vitet e fundit (pa perfshire edhe shume kontrata tjera te perfunduara te cilat bejne pjese ne pune te ngjajshme pasiqe jane ndertim i ulet).

Kontrata te ngjajshme qe plotesojne kerkesat e Autoritetit Kontraktues jane :" Asfaltimi i rrugeve ne fshatin Qulovc", "Rikonstruimi i rruges dhe trotuareve ne rrugen " Sheshi i Arbrit", " Ndertimi i parkut ne lagjen Arberi", "Lot 4 – Ndertimi i rruges Dabishevc-Mutivod", "Ndertimi i infrastruktures rrugore ne lagjen Tasligje", "Implemenetimi i planit te mobilitetit-Sanimi, rikonstruimi i trotuareve"," Ndertimi i sheshit Ahmet Krasniqi",etj.

Vlen te theksohet edhe njehere, te gjitha keto kontrata jane te perfunduara, dhe secila nga to ka te bashkangjitur raportin perfundimtar te puneve.

Pretendimi 2. Kerkese tjeter e AK ka qene:

Dëshmia 3

Për (LOT-1) Për menaxher të projektit CV, diploma e skanuar nga origjinali ose kopja e noterizuar, kontrata e punes, (në rast të angazhimit për këtë projekt, kontrata e menaxherit me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar dhe e nënshkruar nga të dy palet në prezencë të noterit) dhe letër referencat për së paku 1 nje projekte të përfunduara në fushën e rikonstruktimit ose ndërtimit të rrugëve.

Sipas ekspertit shqyrtues kontrata nuk eshte noterizuar ne prani te noterit duke qene se ceket qe eshte sjellur ne zyre nga Znj.Meliza Ademaj. As ky pretendim nuk vlen dhe perben gjithashtu shkelje thelbesore te nenit 38 Sqarimi i Tendereve te Rregullores se Prokurimit Publik.Znj.Meliza Ademaj eshte person qe ka autorizim afarist nga pronari i kompanise. Si e tille, kjo e fundit dokumentin e ka derguar ne zyre te noterit. Ne prani te noterit eshte nenshkruar dokumenti nga ana e inxh. te ndertimtarise Hilmi Mulaku dhe personit ligjerisht te autorizuar per perfaqesim te kompanise. Per kete AK ka mundur te kerkoje sqarime direkte nga Inxhinieri ne fjale dhe nga perfaqesuesi i kompanise gje qe nuk ka ndodhur. Eshte e vertete qe kontrata eshte pregaditur nga ana e kompanise mirepo nenshkrimi i saj ka ndodhur perpara noterit ne prani te dy paleve, siq eshte kerkuar me ane te Dosjes se Tenderit.

Pretendimi 3. Ne lidhje me kerkesen 5 :

Kërkesa 5

Për (LOT-1),

Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve

1. Eskavator me goma minimum 16 ton Minimum 1 copë

2. Riper Luge Hidrauliku minim 2-3 tone minimum 1 copë

Autoriteti Kontraktues i jep te drejte ankeses se OE Graniti SHPK dhe mendimit te ekspertit se nuk plotesojme kerkesen e dyte-lugen e hidraulikut pasiqe DUD-i i prezentuar eshte ne emer te Ejup Rexha dhe nuk ka ndonje deshmi tjeter. Edhe ne kete rast AK ka bere shkelje te nenit 38 Sqarimi i Tendereve te Rregullores se Prokurimit Publik pasiqe ka pasur mundesi te kerkoje sqarime dhe te na jap hapesire te sqarohemi per kete dokument. Theksojme se per kete DUD kemi kontarten e shitblerjes te lidhur ne mes te Bleresit – REXHA SHPK dhe shitesit. Perpos ketij dokumenti kemi prezentuar edhe deshmi tjera per luge hidrauliku (pra posedojme me shume se 1).

Andaj, pas analizimit te gjendjes faktike, pas vleresimit te gjitha provave i Propozojme Organit Shqyrtues qe konform dispozitave te LPP-se te marr kete:

V E N D I M

Aprovohet e bazuar ankesa e Operatoreve Ekonomik " Rexha " SHPK & " Nilaj Engineering " SHPK,

2. ANULOHEN te gjitha veprimet e ndermara nga Autoriteti Kontraktues per refuzimin e kerkeses per Rishyrtim dhe te vazhdohet me njoftimin e pare per dhenie te kontrates te dt.26.01.2023.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet administrative per pergaditjen e tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*